

lajmi.net

Një i vrarë dhe një i plagosur në Klinë

LAJME

13/11/2024 18:04

f

tw

ig

Një ngjarje e rëndë ka ndodhur pak minuta më parë në qytetin e Klinës, ku dyshohet se ka ndodhur një vrasje me armë zjarri.

Rastin për [lajmi.net](#) e ka konfirmuar zëdhënësi i policisë për rajonin e Pejës, Fadil Gashi.

Gashi ka thënë se një person ka humbur jetën si pasojë e këtij incidenti tragjik, ndërsa një tjetër ka mbetur i plagosur.

“Rreth ores 17:17 policia është njoftuar për të shtëna me armë zjarri në sheshin “Mujë Krasniqi”, në një lokal sipas informatave të para një person është pa shenja jete vdekjen e ka konstatuar mjeku kujdestar, ndërsa një person tjetër është dërguar në emergjencë”, ka thënë Gashi.

Lajmi.net, ka kontaktuar dhe me zëdhënësin e Prokurorisë Themelore të Pejës Shkodran Nikçi i cili tha se nuk ka detaje të hollësishme.

“Dy prokurorë të Krimeve të Rënda janë duke dalë në vend të ngjarjes, për detaje më të hollësishme do të ju njoftojmë me kohë” tha Nikçi [/Lajmi.net/](#)

LAJME TË FUNDIT

- Biden e pret Trumpin në Shtëpinë e Bardhë
- Vdes edhe personi i dytë pas të shtënave...
- Ish-kryetari i Apelit: Të dyshuarit për sulmin me...
- Konflikti me armë në Klinë, dyshohet se ka vdekur edhe personi i plagosur

Më shumë nga uebi

Artikuj të ngjashëm

November 13, 2024

Vdes edhe personi i dytë pas të shtënave me armë në...

November 13, 2024

Ish-kryetari i Apelit: Të dyshuarit për sulmin me thikë në Ferizaj...

November 13, 2024

Konflikti me armë në Klinë, dyshohet se ka vdekur edhe personi i plagosur

November 13, 2024

Arrestohet një i dyshuar për të shtënat me armë zjarri në Klinë

November 13, 2024

Dyshohet se dorasi i vrasjes në Klinë është djali i ish-kandidatit...

November 13, 2024

Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës proteston nesër para Ministrisë...